# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-469227**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Blerja e automjeteve përmes KAYO, IKMT: Gjithçka në përputhje me ligjin – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/blerja-e-automjeteve-permes-kayo-ikmt-gjithcka-ne-perputhje-me-ligjin/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 14:36:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 14:34:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `16f96f308e984c4227f6659b277ad6bab20608c345676232b76038b0946dc307` |
| TEKSTI | `33016baca5f07e60552142de5415126113e39e5af38639c61eb8c56135e9e8a5` |
| PAMJA | `68a9edf5cab153726ed63c1a50a13a883e6a492f89f45cd948ecd715f7dec65b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d727244a888acd91616f2c348b671e9d055f78c816ceb963dcaf3325c6d598f2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d727244a888acd91616f2c348b671e9d055f78c816ceb963dcaf3325c6d598f2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

bullgar nga Pusteci: Shqipëria në BE...

5 Me skafandër në kokë dhe armë në dorë, foto e autorit të dyshuar të...

Pretendimi se dokumentet e procedurës janë hartuar pas lëshimit të faturës nga subjekti "Timak Defence" nuk qëndron. Dokumentet zyrtare provojnë krejtësisht të kundërtën. Fatura Nr.83/2026 nga subjekti Timak Defence mban datën 7 Gusht 2026 dhe jo 8 Korrik 2026 siç referohet gabimisht në denoncim.

E gjithë procedura e ndjekur, që nga inicimi deri në kryerjen e pjesës së parapagesës së pjesshme për blerjen e automjeteve është në përputhje me ligjin, aktet nënligjore dhe kontratën e nënshkruar.

Në kuadër të transparencës ndaj opinionit publik, IKMT sqaron sa vijon të gjithë procedurën e ndjekur:

REKLAMË

Në zbatim të VKM-së nr.638 datë 05.11.2025, IKMT ka dërguar pranë shoqërisë KAYO shkresën me nr. 3419 Prot., datë 03.06.2026 "Informacion mbi blerjen e mjeteve të transportit të institucionit IKMT".

Me shkresën nr.399/3 (3419/1 i IKMT-së) Prot., datë 12.06.2026 shoqëria KAYO ka kthyer përgjigje duke dërguar ofertën me specifikimet teknike dhe kohën e lëvrimit të mjeteve.

IKMT me nr. 3419/2 Prot., datë 19.06.2026 ka nxjerrë urdhrin nr.455 datë 19.06.2026 "Për ngritjen e komisionit për blerjen e mjeteve të transportit nga shoqëria KAYO", i cili kishte si detyrë të negociojë me shoqërinë për procedurën dhe të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

REKLAMË

blerjen e mjeteve të transportit, urdhër për të cilin është vënë në dijeni shoqëria KAYO me shkresën nr. 3419/3 Prot., datë 29.06.2026.

Komisioni ka vijuar negociatat me TIMAK DEFENCE në lidhje me specifikimet teknike për blerjen e mjeteve me shkresën nr. 3419/4 Prot., datë 08.07.2026, dhe me shkresën nr. 3419/5 Prot., datë 22.07.2026, shoqëria TIMAK ka përcjellë për dijeni ofertën përfundimtare të mjeteve të transportit për finalizimin e procesit.

Shoqëria KAYO me shkresën me nr.470/4 (3419/6 i IKMT-së) Prot., datë 21.07.2026, ka paraqitur ofertën ekonomike, e cila pasi u analizua nga komisioni, u pranua me proces verbalin nr.3419/7 Prot., datë 27.07.2026.

Në vijim të procedurës u lidh kontrata tripalëshe me nr. 3419/8 Prot., datë 06.08.2026.
Institucioni, mbështetur në kontratën nr.3419/8 Prot., datë 06.08.2026, nenin 14, pika 14.1, gërma ii, nënpika a – cituar – “20 % e vlerës totale të kontratës, përfshirë TVSH-në, do të paguhet si parapagesë”, ka realizuar parapagesën me Urdhër Shpenzimi nr.421, datë 12.08.2026, me vlerë 8,641,296 (tetë million e gjashtëqind e dyzet e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë për faturën nr.83/2026 datë 07.08.2026, për procedurën”Blerje Mjete Transporti”.

Sipas kontratës, pjesa e mbetur të faturës do të likujtohet në momentin kur automjetet do ti dorëzohen Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit.

#IKMT #kayo

WRITTEN BY
**Ana Miha**
Gazetar/e · Vizion Plus

Të gjithë artikujt →

## Vazhdo të lexosh



UNCATEGORIZED

**EMRI/ E kapi droni duke koltivuar lëndë...**

Redaksia Web · 24 Sht 11:19



UNCATEGORIZED

**Macron “thumbon” Trump për Gazën,...**

Ana Miha · 23 Sht 15:17



UNCATEGORIZED

**Turisti gjerman thyen këmbën në Shtegun ...**

Redaksia Web · 23 Sht 12:35

REKLAMË

## Lini një koment

**Komenti juaj** *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.